



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MEDHA

VENDIM

Nr 5 , Datë 23.11 2015

**Për shqyrtim e Planit të Përmbytjeve (mbushjes për herë të parë) të H/C-it Banjë.**

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha morri në shqyrtim materialin e dërguar nga Kompania Devoll Hydropower sh.a, mbi shqyrtimin e Planit të Përmbytjeve për Hidrocentralin e Banjës (version 1), projekti hidroenergjitik i Devollit.

Mbas paraqitjes së materialit, u diskutua nga të gjithë anëtarët e KKDM në lidhje me vlerësimet, kërkesat ligjore dhe aspektet praktike, ekonomike të mbushjes për herë të parë të hidrocentralit të Banjës.

Si çështje e parë vihet re se, në material ka mungesë të kërkesave ligjore, të llogaritjes së përhapjes së valës në anën e poshtme të digës si dhe hartimit të planit të alarmit dhe evakuimit të popullësisë, këto të llogaritura deri në pikën ku ndikimi shuhet plotësisht.

Vec kësaj gjykojmë se në programin e mbushjes do të duhen të meren në konsideratë edhe nevojat për ujëtim dhe përpunimin ujqor të veprave të bujqësisë. Këto nevoja duhet të pasqyroheshin në planin për të paraqitur mundësitë reale të realizimit të mbushjes së H/C të Banjës.

Mbas diskutimeve të anëtarëve të KKDM-së

**V Ë N D O S I:**

1. Shoqëria Devoll Hydropower sh.a do të mund të paiset me autorizimin për mbushjen për herë të parë të digës së Banjës (neni 25 pika 2.4 i VKM nr.147 datë 18.03.2004), vetëm mbas realizimit dhe miratimit në KKDM të studimit mbi përhapjen e valës, në përputhje me kërkesat e pikave 1.1.17 dhe 1.1.18 të

nenit 9, të VKM nr.147 datë 18.03.2004, si dhe planin e alarmit e evakuimit në rast situatë të jashtëzakonshme në përputhje me kërkesat e nenit 26 dhe nenit 28 të VKM nr.147 datë 18.03.2004 për “Rregulloren për sigurinë e digave/dambave”.

2. Në planin e mbushjes për herë të parë mendojme se duhet të merren në konsideratë edhe kërkesat e periudhës, për ujitjen e tokave bujqësore, për veprat si : rezervuari Muriz-Thanë, Kanali Banjë-Shkumbin, etj. Gjykojme se sasia e ujit për këto vepra mund të ketë ndikim të ndjeshëm në programin kohor të mbushjes për herë të parë të H/C Banjë.
3. KKDM shpreh gadishmërinë për bashkëpunimin në realizimin e mbushjes së parë të H/C Banjë, në respekt të legjislacionit në fuqi dhe vecanërisht të ligjit nr.8681 datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, si dhe VKM nr.147 datë 18.03.2004 “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”.

Inxh.Maksim Muci

K R Y E T A R

